



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 932 Date 4.122007

PËR DEPOZITIMIN E STATUTIT TË
SH.A. "UJËSJELLËS KANALIZIME" DELVINË

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimn e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. "Ujësjiellës Kanalizime" Delvinë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENC RULI

AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 22.01.2002 ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime "Ujesjelles -Kanalizime" SH.A Delvine.
2. Objekti I shoqerise eshte:
Furnizon me uje te pishem rrethin e Delvines, miremban rrjetin e kanalizimit te ujrave te zeza ,(KUZ) ne qytetin e Delvines.Kjo mirembajtje konsiston vetem ne rrjetin e jashtem te KUZ.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Delvine, dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 25.000.000.leke ndare ne 25.000. aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
Zj Ermira Spahaj
Z.Orhan Koci
Zj.Mergjyze Bello
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SH.A UJËSJELLËS-KANALIZIMET DELVINË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

V E N D I M

Nr. 08, date 22 / 09 / 2016

(Për miratimin e Statutit të sh.a Ujësjiellës-Kanalizimeve Delvinë)

Ne zbatim të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63, date 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura", Kreu II, pika 1, Statutit Tip të Ujësjiellës Kanalizime (Lidhja nr.1), neni 7, pika "dh", me propozim të Këshillit të Administrimit të sh.a Ujësjiellës-Kanalizimeve Delvinë, Asambleja e Përgjithshme në mbledhjen e datës 22.09.2016

Vendosi:

1. Miratimin e Statutit të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Delvinë, sipas lidhjes bashkalidhur.
2. Ngarkohet organet drejtuese të sh.a Ujësjiellës-Kanalizimeve për organizimin dhe funksionimin në përputhje me këtë statut.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Rigels BALILI

(Kryetar i Bashkisë Delvinë)



